



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E SHTIMES
OPŠTINA ŠTIMLJE/MUNICIPALITY OF SHTIME

Drejtoria për Arsim
Uprava za Obrazovanje/Department of Education

Nr i Protokollit: 05/503

Datë: 14. 6. 2022

Bazuar në Rregulloren Komunale për Ndarjen e Bursave për Studentë me Nr 06/570-60 e datës 30. 3. 2012 me ndryshimet sipas vendimit të Kuvendit të Komunës 01Nr.006/8212 e datës 31. 12. 2016, dhe në bazë të vendimit të Kryetarit të Komunës së Shtimes për caktimin e shumës për ndarjen e bursave për studentë për vitin akademik 2021/2022 për vitin fiskal 2022, me nr. të protokollit 02/232 të datës 14. 6. 2022, Drejtoria Komunale e Arsimit në Shtime shpall:

K O N K U R S
PËR NDARJEN E BURSIVE PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË SHTIMES
PËR VITIN AKADEMIK 2021/2022

Komuna e Shtimes ndanë 50 bursa për studentë, që studiojnë në ndonjë fakultet në arsimin e lartë që ofrohet nga bartësit publik dhe bartësit tjerë të arsimit të lartë në Kosovë, që janë të akredituar, për vitin akademik 2021/2022.

- Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore
- Fakulteti i Mjekësisë
- Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës
- Fakulteti i Arteve
- Fakulteti i Edukimit Fizik dhe i Sportit
- Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë
- Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike
- Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
- Fakulteti i Edukimit
- Fakulteti Filologjik
- Fakulteti Filozofik
- Fakulteti Juridik
- Fakulteti Ekonomik

Bursat do të ndahen për 10 (dhjetë) muaj dhe shuma mujore do të jetë 50 €
Studentët të cilët janë përfitues të bursës në vitin akademik 2020/2021 nga konkursi paraprak janë të obliguar të riaplikojnë.

KRITERET

- I. Kuadri deficitar në komunën e Shtimes
- II. Suksesi më i mirë i studentit
- III. Gjendja e vështirë sociale

- IV. Student i rregullt i ndonjërit prej fakulteteve në arsimin e lartë që ofrohet nga bartësit publik dhe bartësit tjerë të arsimit të lartë në Kosovë, që janë të akredituar.

Në numrin rendor –I- Përparësi do të kenë:

1. Fakulteti i Shkencave Matematike-Natyrore
2. Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës
3. Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike
4. Fakulteti i Mjekësisë – Programi: Mjekësi e Përgjithshme
5. Fakulteti i Bujqësisë dhe Veterinarisë

Në numrin rendor –II-, Përparësi do të kenë:

1. Suksesi (Nota mesatare, 7 e më lart)
2. Studentët e rregullt që kanë të mbaruar vitin e parë të studimeve.

Në numrin rendor –III-, Përparësi do të kenë:

1. Gjendja më e rëndë sociale
2. Në kushtet e njëjta për pikat I,II,III dhe IV përparësi do të kenë:
 - a) Studenti-ja, fëmijë i invalidit të luftës
 - b) Studenti-ja, fëmijë i veteranit të luftës,
 - c) Studenti-ja. Fëmijë i martirit-es së luftës.
 - d) Studenti-ja, me gjendje të rëndë sociale,
 - e) Studenti-ja, që është me aftësi të kufizuara,
 - f) Studenti-ja , pa prind ose në mbikëqyrje të nënës,
 - g) Studenti i prindit të burgosur politik,
 - h) Studenti që ka fituar shpërblim kombëtar ose ndërkombëtar në lëmin e arsimit.

Për t'gjitha këto kategori gjatë aplikimit duhet të sjellin dëshmitë nga soqatat dhe institucionet përkatëse.

Në numrin rendor –IV-, Përparësi do të kenë

1. Student i rregullt i ndonjërit prej Fakulteteve në arsimin e lartë që ofrohet nga bartësit publik dhe bartësit tjerë të arsimit të lartë në Kosovë, që janë të akredituar
2. Studenti-ja banor-rezident i komunës së Shtimes,
3. Studenti-ja, i cili ka dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak

DOKUMENTACIONI QË KËRKOHET PËR KONKURIM:

1. Kërkesa (Aplikacioni) sipas formës së Komunës,
2. Kopja e letërnjoftimit
3. Kopja e indeksit, apo ID-kartelës
4. Certifikata e notave dhe vërtetimi për statusin e studentit (origjinal)
5. Certifikatën mbi vendbanimin e përhershëm,
6. Vërtetimi që studentin nuk është përfutur i bursës universitare.

Fëmijëve të dëshmorëve u ndahen bursat me automatizëm nga viti i parë i studimeve, por në rast të përsëritjes së vitit, studenti e humb të drejtën për bursë

Të drejtën në bursë studentin përsëri mund ta shfrytëzon vetëm pas dorëzimit të dëshmisë për regjistrimin e vitit vijues të studimeve në njërin fakultet.

Komisioni Komunal për ndarjen e bursave do të bëjë përzgjedhjen e studentëve sipas kriterëve të përcaktuara në këtë konkurs dhe konform Rregullores Komunale për Ndarjen e Bursave për Studentë të Komunës së Shtimes.

Aplikacionet merren dhe dorëzohen të kompletuara sipas kërkesës me këtë konkurs në Drejtorinë Komunale të Arsimit, Kati i III-të, në ndërtesën e Komunës së Shtimes.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë prej ditës së shpalljes në web-faqen zyrtare të Komunës së Shtimes dhe tabelën e shpalljeve të Komunës.

